

VENDIM
Nr. 662, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “CONSTRUTORA QUEBEC” LTDA,
“ORTENG EQUIPAMENTOS E SEISTEMAS” LTDA, “GENOSUMI” LTD DHE “PËLLUMB
CELA” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT OSUM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Construtora Quebec” Ltda, “Orteng Equipamentos e Seistemas” Ltda, “Genosumi” Ltd dhe “Pëllumb Cela” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Osum, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha